

Përgjigjet e “testoni njohuritë tuaja”

Testoni njohuritë tuaja 1 – Coffee Bean

Kontrata nuk përmban një qira sepse nuk ka një aktiv të identifikueshëm.

Kontrata është për hapësirën në aeroport dhe operatori i aeroportit ka të drejtën praktike për ta zëvendësuar këtë gjatë periudhës së përdorimit sepse:

- Ka shumë zona të disponueshme në aeroport që do të plotësojnë kushtet e kontratës, duke i siguruar operatorit një aftësi praktike për të zëvendësuar
- Operatori i aeroportit do të përfitojë ekonomikisht nga zëvendësimi i hapësirës sepse do të ketë kosto minimale lidhur me të. Kjo do të lejojë operatorin që ta bëjë sa më efektive përdorimin e hapësirës së disponueshme, duke maksimizuar kështu fitimet.

Testoni njohuritë tuaja 2 – AFG

AFG ka të drejtën e përdorimit të një aktivi të identifikueshëm (një anije specifike) për një periudhë kohe (pesë-vjeçare). Splash nuk mund ta zëvendësojë anijen për një alternativë tjetër.

AFG ka të drejtën për të kontrolluar përdorimin e anijes gjatë periudhës pesë-vjeçare të përdorimit sepse:

- Ai ka të drejtën për të mbajtur të gjitha përfitimet ekonomike nga përdorimi i anijes gjatë një periudhe pesë-vjeçare për shkak të përdorimit ekskluziv të tij të anijes gjatë periudhës së përdorimit.
- Ai ka të drejtën për të drejtuar përdorimin e anijes. Megjithëse ekzistojnë kushtet kontraktuale që limitojnë ku anija mund të lundrojë ose çfarë ngarkese mund të transportojë, kjo përcakton fushën e së drejtës së AFG për të përdorur anijen në vend që të kufizojë aftësinë e AFG për të drejtuar përdorimin e anijes. Brenda fushës së së drejtës së tij të përdorimit, AFG merr vendimet përkatëse rreth si dhe për çfarë qëllimi anija është përdorur gjatë periudhës pesë-vjeçare sepse vendos ku dhe kur anija lundron, si edhe ngarkesën që ajo do të transportojë.

Operacionet e Splash-it dhe mirëmbajtja e anijes nuk ndalon AFG nga drejtimi si dhe për çfarë qëllimi, anija është përdorur.

Prandaj, bazuar në të mësipërmet, kontrata përmban një qira.

Testoni njohuritë tuaja 3 – Dynamic

Afati i qirasë është tre vite. Kjo sepse opsioni për ta zgjatur qiranë është mjaft i sigurtë që do të ushtrohet.

Detyrimi i qirasë llogaritet si më poshtë:

Data	Fluksi i mjeteve monetare (\$)	Norma e skontimit	Vlera aktuale (\$)
31/12/X1	10,000	1/1.05	9,524
31/12/X2	10,000	1/1.05 ²	9,070
31/12/X3	15,000	1/1.05 ³	12,958
			31,552

Kostoja fillestare e të drejtës së përdorimit të aktivitetit llogaritet si më poshtë:

Vlera e detyrimit fillestar	31,552 \$
Kostot direkte	3,000 \$
Pagesa	(1,000 \$)
	<hr/>
	33,552 \$

Regjistrimet e dyfishta janë si më poshtë:

Debi: E drejta e përdorimit të aktivitetit	31,552 \$
Kredi: Detyrimi i qirasë	31,552 \$

Debi: E drejta e përdorimit të aktivitetit	3,000 \$
Kredi: Mjete monetare	3,000 \$

Debi: Mjete monetare	1,000 \$
Kredi: E drejta e përdorimit të aktivitetit	1,000 \$

Testoni njohuritë tuaja 4 – Dynamic (vazhdimi)

Interesi prej 1,578 \$ (W1) ngarkohet në detyrimin e qirasë.

Debi: Kostot financiare (PASH)	1,578 \$
Kredi: Detyrime qiraje	1,578 \$

Pagesa e mjeteve monetare redukton detyrimet.

Debi: Detyrime 10,000 \$

Kredi: Mjete monetare 10,000 \$

Detyrimi ka një vlerë kontabël prej 23,130 \$ në datën e raportimit. Nga kjo, 14,287 \$ (W1) është afatgjatë dhe 8,843 \$ (23,130\$ - 14,287\$) është afatshkurtër.

E drejta e përdorimit të aktivitetit është amortizuar gjatë afatit të qirasë tre –vjeçare sepse ajo është më e shkurtër se jeta ekonomike e dobishme. Kjo na jep një vlerë prej 11,184 \$ (33,552\$/3 vite).

Debi: Amortizimi/ shpenzime amortizimi (PASH) 11,184 \$

Kredi: E drejta e përdorimit të aktivitetit 11,184 \$

Vlera kontabël e të drejtës së përdorimit do të reduktohet në 22,368 \$ (33,552\$ - 11,184\$).

(W1) Tabela e detyrimit të qirasë

Fundi i vitit	Balanca fillestare (\$)	Interesi (5%) (\$)	Pagesat (\$)	Balanca në fund (\$)
31/12/X1	31,552	1,578	(10,000)	23,130
31/12/X2	23,130	1,157	(10,000)	14,287

Testoni njohuritë tuaja 5 – Kinfisher

Viti i parë

Pagesa e parë ndodh në datën e nisjes kështu që është përfshirë në koston fillestare të së drejtës së përdorimit të aktivitetit:

Debi: E drejta e përdorimit të aktivitetit 1 mln \$

Kredi: Mjete monetare 1 mln \$

Detyrimi duhet të matet me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të pa kryera akoma. Pagesat janë variabël pasi ato varen nga një indeks. Ato duhet të vlerësohen duke përdorur indeksin në datën e nisjes (p.sh supozohet që indeksi do të mbetet 125 dhe pagesat do të mbeten 1 mln \$ në vit).

Data	Fluksi i mjeteve monetare (mln \$)	Norma e skontimit	Vlera aktuale (mln \$)
1/1/X2	1.0	1/1.05	0.95
1/1/X3	1.0	1/1.05 ²	0.91

1/1/X4	1.0	1/1.05 ³	0.86
			2.72

Debi: E drejta e përdorimit të aktivit 2.72 mln \$

Kredi: Detyrimi i qirasë 2.72 mln \$

Aktivi është amortizuar gjatë afatit të qirasë prej katër viteve, duke na dhënë një vlerë prej 0,93 mln \$ ((1mln\$ + 2.72mln\$)/4).

Debi: Amortizimi/ shpenzime amortizimi (PASH) 0.93 mln \$

Kredi: E drejta e përdorimit të aktivit 0.93 mln \$

Aktivi ka një vlerë kontabël prej 2.79 mln \$ në datën e raportimit (1mln\$ + 2.72 mln\$ - 0.93 mln\$).

Ngarkimi i interesit në detyrime është 0.14mln \$ (W1).

Debi: Kostot financiare (PASH) 0.14mln \$

Kredi: Detyrimet e qirasë 0.14mln \$

Detyrimi ka vlerën kontabël në datën e raportimit prej 2.86 mln \$ (Ë1).

(W1) **Tabela e detyimit të qirasë**

Fundi i vitit	Balanca fillestare (mln \$)	Interesi (5%) (mln \$)	Balanca në fund (mln \$)
31/12/X1	2.72	0.14	2.86

Dita e parë e vitit të dytë

Kanë mbetur edhe tre pagesa për tu bërë. Pagesa për vitin e dytë është 1.12mln\$ (1mln\$ x 140/125). Detyrimi i qirasë është rimatur për të reflektuar pagesat e rishikuara të qirasë (tre pagesa prej 1.12 mln\$).

Fundi i vitit	Fluksi i mjeteve monetare (mln \$)	Norma e skontimit	Vlera aktuale (mln \$)
1/1/X2	1.12	1	1.12
1/1/X3	1.12	1/1.05	1.07
1/1/X4	1.12	1/1.05 ²	1.02
			3.21

Detyrimi i qirasë duhet të rritet me 0.35 mln \$ (3.21 mln \$ -2.86 mln \$).

Një rregullim përkatës është bërë tek e drejta e përdorimit të aktivit:

Debi: E drejta e përdorimit të aktivit 0.35 mln \$

Kredi: Detyrimi i qirasë 0.35 mln \$

Pagesa prej 1.12 mln \$ do të reduktohet te detyrimi i qirasë:

Debi: Detyrimi i qirasë 1.12 mln \$

Kredi: Mjete monetare 1.12 mln \$

Vlera kontabël e së drejtës së përdorimit të aktiveve prej 3.14 mln \$ (2.79 mln \$ + 0.35 mln \$) do të amortizohet gjatë afatit të mbetur të qirasë prej tre vitesh.

Testoni njohuritë tuaja 6 – DanBob

Një qira financiare është përkufizuar nga SNRF 16 si një qira ku rreziqet dhe përfitimet e pronësisë transferohen nga qiradhënësi te qiramarrësi.

Udhëzimet kryesore, në përputhje me SNRF 16, që një qira është një qira financiare janë si më poshtë:

- Qiraja transferon pronësinë e aktivit te qiramarrësi në fund të afatit të qirasë.
- Afati i qirasë është për pjesën me të madhe të jetës ekonomike të aktivit.
- Në fillimin e qirasë, vlera aktuale e pagesave të qirasë arrin të paktën në thelb të gjithë vlerën e drejtë të aktivit të dhënë me qira.
- Nëse qiramarrësi mund ta anulojë qiranë, humbjet e qiradhënësit mbarten nga qiramarrësi.
- Qiramarrësi mund ta vazhdojë qiranë për një periudhë të dytë në këmbim të pagesave më të ulëta së pagesat e qirasë së tregut.

Afati i qirasë është vetëm për 60% (30vite/50 vite) e jetës së dobishme të aktivit. Titulli ligjor nuk kalon në fund të qirasë. Këto faktorë tregojnë që qiraja është një qira operative.

Megjithatë, qiramarrësi mund ta vazhdojë qiranë e aktivitet në fund të afatit të qirasë me një vlerë që është kryesisht poshtë vlerës së tregut. Kjo tregon që qiramarrësi do të përfitojë nga ndërtesa gjatë jetës së saj të dobishme dhe është një tregues i një qiraje financiare.

Gjithashtu qiramarrësi është i paaftë për ta anuluar qiranë pa paguar DanBob. Ky është një tregues që DanBob është garantuar për të kompesuar/shpërblyer investimin e tij dhe prandaj ata kanë hequr dorë nga rreziqet e pronësisë.

Gjithashtu duket që vlera e tashme e minimumit të pagesave të qirasë do të jetë kryesisht sa e gjithë vlera e drejtë e aktivitet. Minimumi i pagesave të qirasë (duke injoruar vlerën në kohë të parasë) baraz me 40% të vlerës së drejtë, të parapaguara, dhe pastaj 180% tjetër (30 vite x 6%) e vlerës së drejtë gjatë afatit të qirasë. Prandaj kjo tregon përsëri që qiraja është një qira financiare.

Pasi të gjitha gjërat u morrën në konsideratë, duket që qiraja është një qira financiare.

Testoni njohuritë tuaja 7 – Vache

Vache regjistron investimin neto në qira si një llogari të arkëtueshme. Kjo është vlera aktuale e pagesave të qirasë prej 5,710\$.

Llogaria e arkëtueshme është rritur nga të ardhurat financiare. Llogaria e arkëtueshme është reduktuar nga mjetet monetare të arkëtuara.

Viti	Balanca fillestare (\$)	Të ardhurat (15%)	Mjetet monetare të marra (\$)	Balanca në fund (\$)
1	5,710	856	(2,000)	4,566
2	4,566	685	(2,000)	3,251
3	3,251	488	(2,000)	1,739
4	1,739	261	(2,000)	-

Nxjerrë nga pasqyra e pozicionit financiar në fund të vitit të parë

Aktivitet afatgjata:

Investimi neto në qiratë financiare (shiko shënimin) 3,251 \$

Aktivitet afatshkurtra:

Investimi neto në qiratë financiare 1,315 \$

Shënim: aktivi afatshkurtër është kësti tjetër minus interesi i vitit tjetër (2,000\$- 685%). Aktivi afatgjatë është pjesa tjetër (4,566\$ - 1,315\$).

Testoni njohuritë tuaja 8 – Oroc

Oroc mban vinçin në pasqyrën e pozicionit financiar të tij dhe e zhvlerëson atë gjatë jetës së dobishme të tij. Amortizimi vjetor është 35,200\$ (880,000/25 vite) .

E ardhura e qirasë duhet të njihet në fitim ose humbje në bazë të metodës lineare. Faturat totale të qirasë janë 595,000\$ (175,000\$ + (70,000\$ x 6 vite)). E ardhura vjetore e qirasë është 85,000\$ (595,000\$/7 vite). Pasqyra e pozicionit financiar përfshin një detyrim për të ardhurën e shtyrë prej 90,000\$ (175,000\$ - 85,000\$).

Testoni njohuritë tuaja 9 – Painting**Painting**

Painting duhet të heq vlerën kontabël të makinërisë nga pasqyra e saj e pozicionit financiar. Ajo duhet të njoh një të drejtë përdorimi aktivi. E drejta e përdorimit të aktivitetit do të matet si proporcioni i vlerës kontabël të mëparshme që lidhet me të drejtat e fituara nga Painting:

$$(1.9\text{mln}/3\text{mln}) \times 1.2 \text{ mln } \$ = 0.76 \text{ mln } \$$$

Regjistrimi i kërkuar është si më poshtë:

Debi: Mjete monetare	3.00 mln \$
Debi: E drejta e përdorimit të aktivitetit	0.76 mln \$
Kredi: Makineria	1.20 mln \$
Kredi: Detyrimi i qirasë	1.90 mln \$
Kredi: Fitimi ose humbja (shifrat në bilanc)	0.66 mln \$

Shënim: Fitimi në fitim ose humbje është proporcioni i përgjithshëm i 1.8 mln \$ fitim nga nxjerrja jashtë përdorimit (3mln\$ - 1.2 mln\$) që lidhet me të drejtat e transferuara në Collage. Kjo mund të llogaritet si më poshtë:

$$((3\text{mln } \$ - 1.9\text{mln } \$) / 3\text{mln } \$) \times 1.8 \text{ mln } \$ = 0.66 \text{ mln } \$$$

E drejta e përdorimit të aktivitetit dhe detyrimi i qirasë pastaj do të llogaritet duke përdorur rregullat normale të kontabilitetit të qiramarrësit.

Collage

Collage do të regjistrojë si më poshtë:

Debi: Makineria	3.00 mln \$
Kredi: Mjete monetare	3.00 mln \$

Zbatimi i rregullave të kontabilitetit të qiradhënësit. Qiraja është një qira operative sepse vlera aktuale e pagesave të qirasë nuk është e njëjtë me vlerën e drejtë të aktivitetit dhe afati i qirasë nuk është për pjesën më të madhe të jetës së dobishme të aktivitetit. Collage do të regjistrojë të ardhurat nga qiraja në fitim ose humbje në bazë të metodës lineare.